



Projekt i financuar nga BE dhe i mbështetur nga Zyrra e BE-së në Kosovë



Kosovo Legal Services Company



KONKURS PUNE NËPUNËS LIGJOR PËR DIGJITALIZIMIN E TË DHËNAVE TË VJETRA PENALE

Kosovo Legal Services Company (KLSC) është duke implementuar projektin e financuar nga BE, "Sistemi Kombëtar Qendror i Evidencës Penale" (NCCR) 2017-2020. Qëllimet kryesore të projektit janë: a) Mbështetja e Qeverisë së Kosovës në arritjen e progresit në përmirësimin e standardeve të gjyqësorit; b) Krijimi i Sistemit Kombëtar Qendror të Evidencës Penale; dhe c) Digjitalizimi i të dhënave të vjetra penale.

KLSC në bashkëpunim me KGJK-në fton profesionistë të rinj ligjor të aplikojnë për pozitën e nëpunësit ligjor si pjesë e angazhimit për të digjitalizuar të dhënat e vjetra penale dhe popullimin e bazës së të dhënave të NCCR.

Për të mbështetur këtë iniciativë, KLSC planifikon të angazhojë një ekip prej 50 nëpunësve ligjor, të cilët do të punojnë në gjykata për të digjitalizuar dhe populluar bazën e të dhënave të NCCR. Nëpunësit ligjor do të caktohen si në vijim: 2 Nëpunës Ligjor - Zyra Qendrore e NCCR-së / KGJK Prishtinë; 6 Nëpunës Ligjor - Gjkata Themelore e Prishtinës; 3 Nëpunës Ligjor - Gjkata Themelore e Gjilanit; 3 Nëpunës Ligjor - Gjkata Themelore e Pejës; 3 Nëpunës Ligjor - Gjkata Themelore e Gjakovës; 3 Nëpunës Ligjor - Gjkata Themelore e Prizrenit; 3 Nëpunës Ligjor - Gjkata Themelore e Ferizajt; 2 Nëpunës Ligjor - Gjkata Themelore e Mitrovicës - Jug; 2 Nëpunës Ligjor - Gjkata Themelore e Mitrovicës - Veri; 18 Nëpunës Ligjor - Një për secilën Degë; 3 Nëpunës Ligjor - Ekip Mobil, ndërsa raportojnë drejtpërdrejt në Projektin NCCR dhe KLSC. Të gjithë nëpunësit ligjor do të nënshkruajnë një deklaratë konfidencialiteti; shkelja e së cilës do të jetë bazë për ndërprerjen e menjëhershme të kontratës.

Nëpunësve ligjor do të ju caktohen detyrat e mëposhtme:

- Rishikimi i regjistrave të vjetër të gjykatave dhe identifikimi i dënimeve penale;
- Shqyrtimi i të gjitha dosjeve të nevojshme;
- Sistemimi i dokumenteve në përputhje me rregullat e vendosura nga KGJK-ja;
- Regjistrimi i të gjitha rasteve nga regjistrat dhe arkivat e gjykatave ekzistuese të ndryshme, në bazën e të dhënave të NCCR;
- Mbajtja e evidencave të rregullta për dënimet penale;
- Përditësimi i vazhdueshëm i bazës së të dhënave të NCCR;
- Mbështetja e stafit të gjykatave në plotësimin dhe mirëmbajtjen e shënimeve të rasteve në sistemin e të dhënave penale;
- Kryerja e detyrave të tjera të caktuara nga eprori mbikëqyrës;
- Sigurimi i konfidencialitetit të plotë.

Nëpunësit ligjor do të vendosen në gjykatat e mësipërme, por duhet të jenë në dispozicion për të punuar në ndonjë gjykatë tjetër. Kohëzgjatja e kontratës pritet të zgjatë 6 muaj, me mundësi vazhdimi.

Kandidatët e mundshëm duhet të kenë kualifikimet e mëposhtme:

- Diplomë nga Fakulteti Juridik;
- Së paku një vit përvojë pune relevante;
- Aftësi të avancuara kompjuterike, mundësisht me Baza të të Dhënave Elektronike;
- Aftësi për të përpunuar në mënyre elektronike të dhënat administrative me efikasitet dhe korrektësi;
- Aftësi për të lexuar dhe kuptuar stilet e ndryshme të shkrimit të dorës që përdoren për mbajtjen e librave të regjistrit në gjykatat e Kosovës;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi; verbale dhe me shkrim në gjuhën shqipe dhe / ose serbe;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi; verbale dhe me shkrim në gjuhën serbe është e detyrueshme për kandidatët që aplikojnë në pozita në Mitrovicën Veriore;
- Njohja e gjuhës angleze është një avantazh, por jo e detyrueshme;
- Provimi i jurisprudencës është një avantazh, por jo i detyrueshëm;
- Njohuri mbi të drejtën penale, veçanërisht aspektet e procedurës penale lidhur me vendimet përfundimtare të gjykatave dhe rregullave të shlyerjes;
- Aftësi për të punuar në ekupe dhe për t'u monitoruar dhe kontrolluar nga një zyrtar administrativ i gjykatës ku stafi do të vendoset.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë CV-në e tyre në formatin Europass dhe letër motivimi në adresën e mëposhtme: jobs@klsc.eu më së voni më **20 Prill në orën 17:00**, duke treguar qartë në titull të e-mailit: **Nëpunës ligjor të NCCR/Gjykata e preferuar në të cilën doni të caktoheni** (shembull: **Nëpunës ligjor të NCCR/ Gjykata Themelore e Prishtinës**). Për shkak të vëllimit të madh të aplikimeve, do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur. Asnjë telefonatë nuk do të pranohet në lidhje me këtë kërkesë.

Informacione shtesë për kandidatët e interesuar:

Kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për një provim me shkrim si hap i parë i procesit të përzgjedhjes. Kandidatët që do të kalojnë me sukses provimin me shkrim do të ftohen për intervistë verbale nga një panel i përbashkët i KGJK-së dhe Projektit NCCR. Kandidatët e përzgjedhur do të jenë të detyruar të ofrojnë një certificate të gjendjes penale të lëshuar nga gjykata para nënshkrimit të kontratës së shërbimit me KLSC si dhe nënshkrimit të deklaratës së konfidencialitetit.